



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES**

**Tiranë, Janar 2020**

**Prof.Dr. Agron ÇUKA**



**REKTOR**

**RREGULLORE**

**“Për zhvillimin e Konkursit të Pranimit  
Universiteti i Sporteve Tiranë  
Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes”  
Viti Akademik 2020 – 2021**

**DEKAN**

**Prof.Dr. Bardhyl MISJA**



**RREGULLORE E BRENDËSHME MBI PROCEDURËN E ZHVILLIMIT TË**  
**KONKURSIT TË PRANIMIT TË STUDENTËVE**  
**PËR VITIN AKADEMIK 2020 – 2021**

Për të realizuar në praktikë zhvillimin sa më normal të konkursit praktik në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes si dhe për të mbështetur e lehtësuar mundësinë e vlerësimit sa më objektiv e transparent për secilin kandidat kërkojmë të zbatohen me rigorozitet më të madh kërkesat e rregullores së mëposhtme:

**I. E drejta për konkurim**

Të drejtën për konkurimin praktik në Universitetin e Sporteve të Tiranës për vitin akademik 2020 – 2021 e fitojnë:

1. Kandidatët që kanë përfunduar me sukses maturën shtetëror dhe që plotësojnë kriterin e notes mesatare sipas vendimeve në fuqi.
2. Kandidatët që kanë plotësuar formularin A2 pranë sekretarive të shkollave të mesme sipas Udhëzimeve të MASR.
3. Kandidatët që kanë kryer pagesën e tarifës së konkurimit dhe kanë bërë regjistrimin përfundimtar pranë Degës së Informacionit Studentor dhe Regjistrimeve të UST.
4. Kandidatët që kanë plotësuar Kartelën Shëndetësore sipas formatit të UST.

**II. Ngritja e Komisioneve të Konkursit**

Rektori i UST merr masa dhe organizon që në strukturat e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes të ngrihen Komisionet për organizimin dhe mbarëvajtjen e konkursit si më poshtë:

1. Komisioni Qëndror i përbërë nga 3 anëtarë, i cili është përgjegjës për të gjithë ecurinë e konkursit. Anëtarët e këtij komisioni emërohen nga Rektori i UST. Komisioni Qëndror është përgjegjës për shpalljen e rezultateve përfundimtare të konkursit sipas kriteve të përcaktuara. Rektori është Kryetar i këtij Komisioni, në të cilën përfshihen dhe dy drejtuesit e fakulteteve që organizojnë konkursin. Ky vendim do të merret dhe do të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit Qëndror.

2. Komisioni i Vlerësimit të rezultateve praktike përbëhet nga 3 – 5 anëtarë. Ky komision propozohet nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore dhe miratohet nga Rektori i UST.
3. Komisioni i ankimimit i përbërë nga 3 anëtarë (nga të cilët kryetari duhet të jetë jurist), shqyrton të gjitha ankimimet dhe mosmarveshjet gjatë zhvillimit të konkursit dhe shprehet me vendimin përkatës në përputhje me Rregulloren e Konkursit të pranimit në UST. Ky komision propozohet nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore dhe miratohet nga Rektori i UST.

### **III. Procedurat e konkurimit**

1. UST shpall listën emërore të konkuruesve për FSHL sipas rendit alfabetik jo më vonë se një javë përpara datës së konkurimit për Vitin Akademik 2020–2021.
2. Konkurimi Praktik fillon në orën 9.<sup>00</sup>. Paraqitja e konkurrenteve bëhet në orën 8.<sup>00</sup>. Kjo orë së bashku me datën e konkurimit shpallet jo më vonë se një javë përpara ditës së konkurimit.
3. Lejohet të hyjnë në mbientet ku zhvillohet konkursi vetëm kandidatët e listës së shpallur për konkurim të cilët duhet të jenë të pajisur me dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë biometrike). Kandidatët që nuk kanë asnjë nga këto dokumenta identifikimi nuk do të lejohen të marrin pjesë në konkurs.
4. Përpara konkurimit kandidatëve u komunikohen rregullat e konkursit të pranimit.
5. Testet praktike për konkursin e pranimit hartohen nga Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes dhe miratohen nga Senati i UST-së.
6. Testet e konkursit praktik u vihen në dispozicion konkuruesve të paktën 3 muaj përpara datës së konkursit.
7. Në momentin e regjistrimit, konkuruesit i jepet kartela personale e konkurimit në të cilën konkuruesit i shënohen rezultatet e arritura në 2 Testet Praktike (Koha në sekonda dhe Distanca në metra).

**8. Rradha e disiplinave konkurse do të jetë:**

- a. Testi - kërcim së gjati nga vendi 2 (dy) prova (shënohet rezultati më i mirë).**
- b. Testi - circuit, kryhet vetëm 1 (një) provë pa të drejtë përsëritjeje.**

- 9.** Komisioni i Vlerësimit cakton 1 (një) anëtar që komunikon me zë rezultatin dhe 1 (një) anëtar që shënon rezultatin e çdo konkuresi në kartelën e tij personale. Shënimi i rezultatit bëhet me stilolaps ngjyrë blu. Rezultati shënohet pa korigjim në fletën zyrtare të konkurimit, pas komunikimit me zë të lartë të këtij rezultati dhe 1 (një) anëtar tjetër pranë tij hedh këtë rezultat në kartelën personale të konkuresit duke firmosur ai vetë dhe konkuresi në këtë kartelë.
- 10.** Në rast të mos përputhjes së nivelit të rezultatit të shënuar në fletën zyrtare dhe në kartelën personale të konkuresit, personi përgjegjës do të mbajë përgjegjësi të plotë ligjore.
- 11.** Përveç anëtarëve të komisioneve dhe përfaqesuesve të komisionit qëndror ose personave të autorizuar prej tij asnjë i huaj, për asnjë arsye nuk mund t'i afrohet komisioneve të vlerësimit.
- 12.** Për zhvillimin normal e të qetë të konkursit lajmërohet Komisariati i Policisë për angazhimin e policisë në tërë objektet ku zhvillohet konkurimi praktik.
- 13.** Lista përfundimtare e fituesve të konkursit do të shpallet nga Komisioni Qëndror. Pas përfundimit të konkursit praktik, do të shpallen pikët e fituara nga çdo konkuresi i cili do të mund të kontrollojë dhe të krahasojë me pikët e fituara sipas kartelës së tij personale vetëm nëpërmjet numrit të ID.
- 14.** Rezultatet e konkurimit praktik pasqyrohen në formularë të posaçëm zyrtar, të firmosur nga Rektori i UST, të plotësuar pa korigjime dhe të firmosur nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit. Pas përfundimit të konkurimit këto formularë depozitohen në Arkivën e institucionit.
- 15.** Rezultatet përfundimtare do të shpallen jo më vonë se 24 orë pas përfundimit të plotë të konkurimit.
- 16.** Secili konkurent ka të drejtën e ankimit me shkrim të rezultatit pranë komisionit përkatës të ngritur qëllimisht për shqyrtimin e tërë ankesave duke dorëzuar atë pranë Sekretarisë së Universitetit të Sporteve.

17. Ankimimi bëhet Brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve përfundimtare, kjo edhe nëse brenda kësaj periudhe 2 ditore qëllon ditë e shtunë ose e djelë.
18. Pas 48 orëve nga shpallja e rezultatit, brenda ditës Komisioni i Ankimimit pas rivlerësimit paraqet proces-verbalin përkatës me vendimin e formës së prerë në komisionin e vlerësimit/qendror.
19. Pas kësaj periudhe, Komisioni Qëndror i konkursit shpall listën përfundimtare të rezultateve të konkursit.
20. Mbështetur në Vendimin Nr.9, datë 27.02.2018 pika 2, të Senatit të UST-së: “Kandidati konkuroes, duhet të marrë së paku 10 pikë në testimin e konkursit praktik. Nëse merr më pak se 10 pikë, kandidati nuk shpallet fitues dhe nuk rregjistrohet për të ndjekur studimet”

Në rast se gjatë konkurimit kërkohet ndonjë zgjidhje e paparashikuar në këtë Rregullore apo për ndonjë arsye tjetër të cfarëdo lloji qoftë ajo, komisioni ka të drejtën e vendimmarrjes.

Kjo vendimmarrje do të pasqyrohet në një proces-verbal të veçantë në momentin e vendimit duke shpjeguar argumentet përkatëse.

**Normat e pranimit do të jenë të afishuara në ambjentet e hapura publike si dhe në faqen zyrtare të UST.**